



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. 2064 Prot.

Tiranë, më 23/05/2024

Lënda: Kërkohet motion me debat, si dhe shqyrtimi dhe miratimi në seancën plenare të Projektrezolutës “Për mbrojtjen e gazetarëve nga dhuna e çdo lloj forme; fundin e pandëshkueshmërisë ndaj dhunuesve dhe njohja e rolit të pazëvendësueshëm të medias së lirë e të pavarur në zhvillimin e demokracisë në Shqipëri”

Drejtuar: ZONJËS LINDITA NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Baza Ligjore: Nenet 55, 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit

Znj. Nikolla

Media luan një rol themelor në demokraci, duke i garantuar qytetarëve që të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u informuar, për të shqyrtaur dhe për të gjykuar veprimet dhe vendimet e autoriteteve publike dhe si rrjedhojë të formësojnë opinionin dhe mendimin e tyre mbi qeverisjen e vendit. Për këtë qëllim, garantiimi i lirisë së shprehjes nga autoritetet publike është tregues i funksionimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit. Mediat e lira dhe të pavarura, shkëmbimi i lirë i informacionit, kanë një rol vendimtar në transformimet demokratike që ndodhin në regjimet jo plotësisht demokratike apo me demokraci të re si Shqipëria.

Liria e medias është një gur-themeli i vlerave, të përfshira në Traktatin e Bashkimit Europian, dhe për pasojë është një element kyç në procesin e integrimit europian të Shqipërisë dhe kriter themelor politik i Kopenhangenit, duke shërbyer në këtë mënyrë si një kriter kualifikues për pranimin e vendeve kandidate, përfshirë Shqipërinë, në Bashkimin Europian.

Nga ana tjetër, barazia gjinore, ndalimi i diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave janë kushte të rëndësishme për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian si dhe një ndër objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Axit të 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara;

Për fat të keq, gjatë kësaj kohe media dhe gazetarët në Shqipëri kanë qenë subjekt i presionit ekonomik dhe politik nga Qeveria. Sjellim në vëmendjen tuaj rastet e shumta të shkarkimeve të padrejta nga puna të gazetarëve, kërcënimet apo dhunimet ndaj gazetarëve (shiko disa nga rastet sipas listës bashkëlidhur kësaj shkresë). Këtyre rasteve i shtohet edhe rasti i fundit, sjellja e paprecendent e Kryeministrit Edi Rama ndaj gazetares së SYRI TV Ambrozia Meta. Z. Rama në vijimësi ka përdorur fjalë e qëndrim fyes e denigrues ndaj pyetjeve të saj, duke e sulmuar apo fyer gjatë komunikimeve publike. Në rastin e fundit edhe duke e dhunuar dhe cënuar integritetin fizik të saj.

Kjo sjellje përbën një agresion të paprecendent dhe përdorim të gjuhës poshtëruese dhe joetike ndaj gazetarëve në ushtrim të detyrës së tyre. Për pasojë, kjo sjellje dhe kjo gjuhë, është e papranueshme për ne gratë deputete të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe vlerësojmë se duhet të dënohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

Nisur nga sa më lart, në mbështetje të nenit 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit, paraqesim këtë mocion me qëllim zhvillimin e një debati në Kuvend për sjelljen e papranueshme dhe të paprecendent të Kryeministrit Edi Rama ndaj gazetareve gra, sipas tekstit bashkëlidhur kësaj kërkesë për zhvillimin e mocionit. Në mbështetje të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi i Shqipërisë të Projekt Rezolutës "Për dënimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe poshtëruese nga Kryeministri Edi Rama ndaj gazetarëve, si dhe njohjen e rolit të pazëvendësueshëm të medias së lirë në zhvillimin e demokracisë në Shqipëri".


Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETËT:

1) Ina Zhupa 

2)

Juile Teodoroff 

3) Lheni Gjergji 

4)

Shnate Cupri 

5) Endri Kolbi 

6)

Sorina Koto 

7) Finolitor Me Yolliq 

8)

Albeno Vohshi 

9. Elida Hoti 

10. Ilde Shoni 

LISTA E DISA RASTEVE TË DHUNËS APO PRESIONIT NDAJ GAZETAREVE

1. Gusht 2016

Alida Tota- ish Drejtoresha e Lajmeve në A1 News pushohet nga puna dhe investigimi për landfillin e Sharrës ndërpritet me urdhër të Kryebashkiakut Veliaj si bashkëAdministrator i landfillit me kompaninë “3R” në pronësi të Kryetarit të PS, Peqin.

2. Tetor 2016

Gazetarja Tota bashkëpunon me kolegët e emisionit “Publicus” për të vazhduar investigimin e ndërprerë për vdekjet tragjike në landfillin e Sharrës. Dokumentari i titulluar ”Kodrina e Vdekjes” vazhdim i investigimit në landfill nuk u lejua të transmetohet nga pronarët e Televizionit Vizion Plus. Ekipi i “Publicus” i drejtuar nga producenti Artan Rama pushohet nga puna. Pas censurimit dokumentari investigativ publikohet në youtube.

3. Tetor 2016

Gazetarët e censuruar kërkuan seancë dëgjimore në Komisionin Parlamentar të Medias për të denoncuar censurimin e investigimit nga Kryetari i Bashkisë Tiranë dhe urdhrin për pushimin e tyre nga puna. Seanca dëgjimore me gazetaren Tota dhe kolegët e Publicus; Artan Rama, Jetmir Olldashi dhe Endrit Habilaj bllokohet 6 herë radhazi nga deputetët e PS. Përfaqësuesi i PS, ish Nënkyryetari i Komisionit të Medias, Alfred Peza urdhëron Gardën e Republikës për të penguar seancën dëgjimore me gazetarët e censuruar.

7. Maj 2017

Gazetarët Simon Shkreli dhe Eliona Shkreli (bashkëshortë) që drejtonin edicionin qëndror të lajmeve në TV1 Channel në Shkodër pushohen nga puna për një status në Facebook

11. Janar 2018

Gazetarja e kronikës në Televizionin Publik, Anduena Llabani gjobitet dhe paralajmërohet për largim nga puna pas komenteve të saj në një studio televizive, për lidhjet e vëllait të Kryeministrit Rama (Olsi Rama) me të dënuarit e Xibrakës.

Gusht 2018

Sulmi me armë në shtëpinë e familjes së gazetares Klodianë Lala, e cila kishte denoncuar përfshirjen e policisë në trafikun e drogerave, apo lidhjen e deputetëve të PS me bandat kriminale. Ngjarja e sulmit me armë ndaj shtëpisë së prindërve të saj është ende në hetim. Sic gazetarja Lala pohon për Zërin e Amerikës, “janë

shtuar sulmet on line dhe kërcënimet anonime, pre e të cilave ka qenë dhe ajo. Këto sulme janë të vështira për t'u zbuluar”

Nëntor 2018

Gazetarja Beti Njuma sapo kishte filluar punë si drejtoreshë e Informacionit në Televizionin “Ora News”. Erion Veliaj i pakënaqur nga mënyra se si i bënte lajmet ajo dhe përfaktin se kasetat e tij të gatshme nuk transmetoheshin në këtë ekran, filloj presionet ndaj pronarit për shkarkimin e saj. “*Nuk do të mendoja kurrë se do të lejoje një hajvane të futej mes nesh*” i ka shkruar ai Ylli Ndroqit në vjeshtën e 2018, duke e ofenduar gazetaren si idiote dhe duke kërcënuar se nuk do t’i falte kurrë atë që po bënte.

18 shtator 2018

Gazetarja Aranita Brahja, drejtoresha e “Open Data”, u kërcënuar në zyrën e saj për të hequr të dhënat e një kompanie në shkrimin e botuar në faqen e saj të web me fjalët: “Kjo zyrë nuk do të ekzistojë”.

Dhjetor 2020

Një prej formave të kërcënimit të gazetarëve janë edhe paditë që ngrihen ndaj tyre në Gjykatë. Besar Likmeta dhe Aleksandra Bogdani të Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative, thonë se janë paditur nga biznesmeni Mirel Mërtiri dy vjet më parë, pas një shkrimi investigativ për aferën e inceneratorëve, për të cilën kishte interes publik. Gazetarët Likmeta dhe Bogdani e kanë fituar çështjen në gjykatën e shkallës së parë. Këto padi të njoitura si “SLAPP” synojnë të shkaktojnë frikë dhe heshtje tek gazetarët.

6 Nëntor 2021

Gazetarja Anila Hoxha, gjatë raportimit të një ngjarje kriminale, u dhunua bashkë me një koleg kameraman, nga një punonjës policie. Por ajo që përjetoi me pas në rrjetet e saj sociale ishte edhe më e rëndë. Gjatë diteve në vazhdim, ishin rritur sulmet në rrjetet sociale të saj, «sulme të orientuara, me adresë false, të organizuara, kërcënuese, shantazhuese dhe të paperceptueshme.” – sic ka pohuar vetë gazetarja Hoxha për Zërin e Amerikës

17 korrik 2023

Gazetarja Ola Xama kërcënohet nga Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Veliaj pasi ajo më parë e kishte kontaktuar në lidhje me një reagim që kishte të bënte me aktualitetin. Mesazhi i Veliajt ishte si më poshtë: ‘*Ola, ti nuk je gazetare! Je një killer me pagesë! Nise të bësh një vrasje, por kishe objektiv të gabuar dhe nuk*

të shkrepit arma! E di që nuk e njeh turpin, por BIRN i dhe një njollë që nuk do harrohet kollaj! Fundjavë të mbarë! .

19 mars 2024

Gazetarja Ambrozia Meta është fyer në mënyrë të përsëritur, intimiduar, e dërguar “në riedukim” nga kryeministri Edi Rama si dhe cënuar fizikisht nga ai ndërsa gazetarja po priste që Kryeministrin të dilte në deklaratë pas një mbledhje në selinë e PS. Teksa i ka drejtuar pyetjen, Edi Rama ka refuzuar të përgjigjet duke e prekur në fytyrë.

REZOLUTË

Nr. _____ /2024

PËR MBROJTJEN E GAZETAREVE NGA DHUNA E CDO LLOJ FORME FUNDIN E PANDËSHKUESHMËRISË TË DHUNUESVE DHE NJOHJA E ROLIT TË PAZËVENDËSUESHËM TË MEDIAS SË LIRË E TË PAVARUR NË ZHVILLIMIN E DEMOKRACISË NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 55, 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI I SHQIPËRISË:

1. Duke mbajtur në vëmendje:

- Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj që sanksionojnë se gjëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnje dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
- Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut Neni 10 dhe neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë garantojnë Lirinë e Shprehjes si një prej të Drejtave Themelore të Njeriut;
- Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut Neni 19, Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave Civile dhe Politike Liria e shprehjes Neni 19; praktikat gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut; deklaratat, rekomandimet dhe rezolutat e Komitetit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, si dhe dokumentet e Komisionit të Venecias dhe Komisionerit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës sanksonojnë të drejtën për informim dhe medias të lirë;
- Marrëveshjen Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën e Kombeve të Bashkuara "Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave ("CEDAW")," dhe Protokollin e saj shtesë, si dhe Rekomandimin e Përgjithshëm te Komitetit CEDAW mbi dhunën kundër grave;

- Konventën e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje” që përcakton detyrimet e shteteve të shmangin përfshirjen në akte dhune kundër grave;
- Legjislacionin e brendshëm për mbrojtjen e grave nga dhuna;
- Kartën Europiane për Lirinë e Medias, Rezoluta e Parlamentit European të datës xxx dhe Raporti i Progresit të Komisionit European për Shqipërinë 2022
- Raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut për Shqipërinë
- Raportet e organizatave ndëkombëtare të medias Reporterët pa Kufij etj;
- Raportet e OSBE/ODIHR për zgjedhjet në Shqipëri;

KUVENDI I SHQIPËRISË

Duke vlerësuar arritjen e barazisë gjinore, luftimin e diskriminimit dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave si, kushte të rëndësishme për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian si dhe një ndër objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Axhendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara;

Duke marrë në konsideratë përkeqësimin e lirisë së medias, ku ne Indeksin e Reporterëve pa Kufij 2023, Shqiperia renditet ne vendin e 96 nga 180 vende te perfshira ne raport;

Duke qenë të ndërgjegjshëm se media luan një rol themelor në demokraci, duke iu garantuar qytetarëve që të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u informuar, për të shqyrtuar dhe për të gjykuar veprimet dhe vendimet e autoriteteve publike dhe si rrjedhojë të formosojnë opinionin dhe mendimin e tyre mbi qeverisjen e vendit;

Duke pasur parasysh se garantimi i lirisë së shprehjes nga autoritetet publike është tregues i funksionimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit, si dhe faktin se mediat e lira dhe te pavarura apo shkëmbimi i lirë i informacionit, kanë një rol vendimtar në transformimet demokratike që ndodhin në regjimet, jo plotësisht demokratike apo me demokraci të re;

Duke vlerësuar se liria e medias është element kryesor në procesin e integrimit europian të Shqipërisë dhe kriter themelor politik i Kopenhangenit, duke shërbyer në këtë mënyrë si një kriter kualifikues për pranimin e vendeve kandidate në Bashkimin Evropian;

Duke qene të ndërgjegjshëm se liria e medias është efikase nëse gazetarët janë të lirë nga cdo formë presioni të pronarëve, drejtuesve dhe qeverisë, si dhe nga cdo cënim moral dhe fizik, kërcënimi financiar apo përdorimi i gjuhës së papërshtatshme dhe nxitëse të urrejtjes ndaj tyre;

Duke mbajtur në konsideratë se të drejtat themelore të qytetarëve për lirinë e shprehjes dhe informimit mund të garantohen vetëm përmes lirisë së medias dhe pluralizmit, ku gazetarët dhe mediat mund të ushtrojnë të drejtën dhe detyrën e tyre për të informuar qytetarët në mënyrë të drejtë dhe neutrale dhe të raportojnë në mënyrë të paanshme për ngjarjet dhe vendimet me interes publik; ndërsa të gjithë anëtarët e shoqërisë, përfshirë autoritetet publike, kanë të drejtë të shprehin pikëpamjet e tyre në mënyrë demokratike dhe paqësore, pa fyerje apo sulme ndaj gazetarëve;

Duke njojur me shqetësim sfidat dhe presionet me të cilat ballafaqohen mediat në Shqipëri, në drejtim të pavarësisë redaksionale, punësimit të pasigurtë, vetëcensurës, neutralitetit dhe cilësisë së informacionit, qasjes dhe financimit, si dhe ndërhyrjet politike dhe financiare;

Duke vlerësuar me shqetësim që statusi i grave dhe vajzave në Shqipëri vecanërisht atyre që janë pjesë e medias është përkeqësuar e në mënyrë të përsëritur nga ana e Kryeministrit Edi Rama, qeveritarëve apo Kryetarëve të Bashkisë kërcënohen, shantazhohen deri ne cenimin e integritetit moral e fizik;

Duke qenë në dijeni të faktit se një pjesë e madhe e gazetareve (gra e vajza) punojnë nën presionin e humbjes se vendit te punes, kercenohen dhe ne shume raste as nuk paguhen nga punedhenesit e tyre ;

Duke mbajtur në konsideratë se gjatë kësaj kohe media ka qene subjekt i presionit ekonomik dhe politik nga qeveria, me pasoje censurimin e gazetarise cilesore qe garanton llogaridhënien nga ana e autoriteteve publike dhe politike;

Duke risjellë në vëmendje rastet e shumta të shkarkimeve të padrejta nga puna të gazetareve, kërcënimet, shantazhet, intimidimet apo dhunimet ndaj gazetarëve;

Duke mbajtur në konsideratë sjelljen e paprecendentë të Kryeministrit Edi Rama ndaj gazetareve, i cili në vijimësi i fyeni , i sulmon apo i dhunon fizikisht gazetaret qe i drejtojne pyetje mbi llogaridhenien e qeverise;

KUVENDI I SHQIPËRISË:

Konstaton me shqetësim ekzistencën në rritje të dhunës ndaj grave dhe vajzave në përgjithësi;

Mban në konsideratë se parandalimi dhe kufizimi i rasteve të dhunës ndaj grave në të gjitha format e shfaqjes së saj, është i ndërlidhur me një sërë faktorësh që kërkojnë angazhim të gjithanshëm;

Vëren se sistemi i drejtësisë nuk ka qenë efektivë lidhur me hetimin dhe shqyrtimin e rasteve të dhunës dhe shantazhimit të gazetarëve kryesisht ndaj grave gazetare;

Vlerëson rolin e rëndësishëm që ka media e lirë dhe e pavarur në shërbim të interesit publik dhe forcimit të demokracisë;

Nënvizon detyrimin institucional që ka media për të ofruar informacion të saktë dhe të besueshëm, të pavarur nga presionet dhe interesat private apo politike, që i shërbejnë mbrojtjes së interesit publik;

Thekson se pluralizmi i medias dhe pavarësia editoriale janë shtyllat e lirisë së shtypit;

Vlerëson se rritja e pjesëmarrjes dhe rolit të grave në media është faktor kyç edhe për fuqizimin e grave dhe vajzave;

KUVENDI I SHQIPËRISË:

Dënon fuqimisht aktet e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe në veçanti dhunën ndaj grave gazetare, duke i konsideruar si fenomene që cenojnë bazën e shoqërisë dhe lirinë e medias si dhe kërkon masa të ashpra ndaj dhunuesve, duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të shoqërisë;

Angazhohet nëpërmjet komisioneve të tij të përhershme parlamentare dhe nënkomisioneve të tij të monitorojë zbatimin nga autoritetet shqiptare të zbatimit të akteve ligjore, akteve ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe vecanërisht dhe atyre që garantonin lirinë e medias dhe mbrojtjen e gazetarëve;

Thekson rëndësinë e miratimit të kodeve të sjelljes për pavarësinë editoriale.

Kërkon krijimin e kushteve të sigurta, me garancitë e duhura ekonomike dhe sociale dhe kërkon përmirësimin e kushteve të punës të grave ne media.

Thekson rëndësinë dhe inkurajon monitorimin periodik nga Avokati i Popullit dhe organizatat joqeveritare, të lirissë dhe pluralizmit të medias dhe kërkon prej tyre raportimin në baza vjetore në lidhje me këto çështje në Komisionin përgjegjës parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e grave

gazetare, ndërhyrjen e qeverisë, përdorimin e gjuhës së urrejtjes apo fyeze ndaj tyre, persionit, kërcënimeve apo dhunimit, ngacmimit të grave gazetare ndërsa janë në detyre.

I kërkon Komisionit dhe Nënkomisionit Parlamentar për Cështjet e Barazisë Gjinore, Komisionit Parlamentar përgjegjës për cështje të lirisë së medias, që të ndërmarrin cdo iniciativë ligjore për të garantuar jo vetëm lirinë e medias në Shqipëri, por për të parandaluar dhe ndëshkuar cdo përdorim dhune, kercenimi, gjuhë urrejtje dhe fushata denigruese ndaj gazetareve.

I bën thirrje pronarëve dhe drejtuesve të medias apo shoqatave të gazetarëve që të marrin masat e duhura, kur lindin shqetësime në lidhje me lirinë e shprehjes, informimit, lirisë së medias dhe mbrojtjes së statusit të grave gazetare, si dhe i kërkon atyre që të garantojnë lirinë dhe integritetin e gazetareve, duke mos pranuar agresionin e përditshëm të Kryeministrit Edi Rama apo zyrtarëve të tjerë të lartë qeveritar.

Inkurajon gazetaret të reagojnë e të mos pajtohen me sulmet neveritëse të cdo zyrtari publik, apo përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe fyeze ndaj tyre gjatë ushtrimit të detyrës.

Kërkon nga Komisioni European që të monitorojë nga afér lirinë e shtypit në Shqipëri, ndikimin negativ që ka përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe fyerjes ndaj gazetareve, si dhe kërkon reagimin e tyre për të dënuar sjelljet e papranueshme të cdo zyrtari ndaj gazetareve si akte që cënojnë rëndë lirinë e shprehjes në Shqipëri dhe rrugëtimin e vendit tonë si vend kandidat për tu anëtarësuar në Bashkimin European.

Ngarkon Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit që t'ia përcjellë këtë Rezolutë Komisionit European, OSBE-së, Komitetit të Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, si dhe Komisionerit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës.

Tiranë, më ____ / ____ /2024

KRYETARE

LINDITA NIKOLLA